

# Raporti Vjetor 2007



**Banka  
Ekonomike**  
Traditë dhe siguri



<b>1. Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm</b>	2
<b>2. Bordi Menaxhues</b>	4
<b>3. Këshilli Drejtues</b>	5
<b>4. Struktura organizative e Bankës Ekonomike</b>	6
<b>5. Vizioni dhe misioni</b>	7
<b>6. Ambienti makroekonomik i ekonomisë kosovare</b>	9
6.1 Produkti i brendshëm bruto (GDP)	10
6.2 Tregtia e jashtme/Bilanci tregtar	11
6.3 Inflacioni	11
6.4 Sistemi bankar	12
<b>7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike</b>	15
7.1 Kreditimi	15
7.2 Depozitat	17
7.3 Llogaritë bankare	19
7.4 Lansimi i produkteve/shërbimeve të reja	20
7.5 Thesari	20
7.6 Qarkullimi i pagesave	21
7.7 Menaxhimi i riskut kreditor	23
7.8 Burimet njerëzore	24
7.9 Zgjerimi i degëve dhe modernizimi i tyre	25
<b>8. Raporti i auditorëve të pavarur</b>	28
<b>9. Pasqyrat financiare</b>	35
<b>10. Adresat dhe kontaktet</b>	74

Viti 2007 ishte një vit i ndryshimeve në Bankën Ekonomike, me prioritet zhvillimin e bankës duke investuar në ndertimin e kapaciteteve humane, leshimin e shumë produkteve të reja si dhe avansimin e identitetit korporativ të bankës.

Që nga themelimi Banka Ekonomike ka hasur në sfida teknike, resursesh njerëzore dhe institucionale. Këto sfida kanë kërkuar një angazhim të madh të punonjësve tanë, si dhe përkushtim të plotë të tyre për të ndërtuar një institucion bashkëkohor, që synon të jetë konkurrent serioz në treg.

Nga fundi i muajit korrik 2007 ndodhën ndryshimet në menaxhmentin e Bankës Ekonomike, ku me vendim të Këshillit Drejtues u ndërrua Drejtori Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv, në kuadër të përpjekjeve që banka të menaxhohet nga një staf me vizion më të gjërë që do të shpie bankën drejt zhvillimit dhe suksesit në përgjithësi.

Me ardhjen e menaxhmentit të ri është krijuar një strukturë e re organizative në të cilën janë krijuar disa departamente të reja siç janë: Departamenti i Riskut, Departamenti i Zhvillimit të Biznesit, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Marketingut.

Gjithashtu janë lansuar shumë produkte të reja të cilat kanë bërë me atraktive Bankën Ekonomike para klientëve. Fokus i vecantë iu është kushtuar bizneseve të vogla, si dhe përkrahjes së bujqësisë, sektorë që krijojnë më së shumti vende të punës dhe janë faktorë kyç në zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjatë vitit 2007 është punuar shumë në modifikimin dhe krijimin e politikave dhe procedurave të ndryshme të bankës në fushat e riskut kreditor, thesarit dhe burimeve njerëzore, të cilat mundësojnë funksionimin optimal të bankës.

Në shtator 2007, pas ekzaminimit të AQBK-së është kërkuar nga po ky autoritet që të ndajmë rezervë shtesë në vlerë prej 956.000 EUR për kreditë të cilat kanë qenë në vonesë. Kjo ndarje e rezervës ndikoi në zvogëlimin e profitit në aspektin afatshkurtër, mirëpo banka menjëherë ndërmoi aksion dhe u paditën të gjitha rastet për të cilat kemi qenë të obliguar të ndajmë rezervë.

Pavarësisht nga kjo, Banka ka punuar intenzivisht me qëllim që të perfundojë afarizmin në fund të vitit me rezultat pozitiv, gjë që është arritur pas shumë sfidave.

Asetet e Bankes kanë shënuar rritje prej më shumë se 9.43%, depozitat kanë shënuar rritje prej 3%, kreditë kanë shënuar rritje prej 35.3%, gjë që ka ndihmuar edhe në rritjen e të hyrave të Bankës ndërsa numri i klientëve ka shënuar rritje prej 11.44%.

Gjatë kësaj periudhe kemi caktuar edhe standardet për dukje të degëve të reja, në mënyrë që të jemi sa më shumë prezentë në syrin e klientëve, gjë që është pëlqyer shumë prej tyre. Tashmë Banka Ekonomike ka degët me dukje të njëjtë dhe moderne, të cilat ju mundësojnë klientëve qasje më të lehtë dhe me më shumë komoditet në kryerjen e shërbimeve bankare.

Janë zhvilluar trajnime të ndryshme me qëllim të përgatitjes së stafit për të ofruar shërbime sa më të mira për klientët.

Ne si menaxhment i ri, përballemi me sfidën që t'i sigurojmë Bankës Ekonomike dhe personelit të saj një vizion të qartë mbi objektivat, përgjegjësitë dhe punën në të ardhmën. Andaj është e qartë që ne si menaxhment, duhet të krijojmë një bazë të fortë për të mundësuar veprimtarinë e Bankës brenda një mjedisi më të lëvizëshem, me një konkurrencë mjaft të fortë dhe agresive, si dhe me identifikimin e sfidave përkatëse dhe ato më të rëndësishme që janë para nesh.

Në përmbyllje, dëshiroj t'u shpreh mirenjohjen të gjithë aksionareve të Bankës Ekonomike, Këshillit Drejtues dhe të gjithë punonjësve të Bankës për angazhimin e tyre për realizimin qëllimeve të parashtruara.

Valon Lluka





**Valon LLUKA**  
Drejtore i përgjithshëm

**Fisnik KËPUSKA**  
Zëvendës Drejtore i përgjithshëm

*Këshilli Drejtues i Bankës Ekonomike ka këtë përberje:*

**Hajrullah ZAITI**  
Kryetar

**Raif REXHEPI**  
Zëvendëskryetar

**Hasan HAJDARI**  
Anëtar

**Xhabir KAJTAZI**  
Anëtar


**Selim PACOLLI**  
Anëtar

**Rame REXHA**  
Anëtar

**Qerim RAMADANI**  
Anëtar

**Ismet GJOSHI**  
Anëtar

**Valon LLUKA**  
Anëtar, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës





Banka Ekonomike do të jetë një bankë transparente, e hapur, me përgjegjësi sociale, e orientuar në sigurimin e shërbimeve cilësore për klientët duke ofruar standarde të larta profesionale.

Misioni ynë do të jetë të jemi ofrues vendas modernë shërbimesh bankare e financiare, duke ofruar cilësi e vlerë, nëpërmjet operimit me teknologji të avancuara moderne, kapacitete të larta menaxheriale e performancë të lartë në përmbushjen maksimale të nevojave të klientëve tanë.

Në funksion të arritjes të misionit tonë, ne synojmë të sigurojmë një përdorim racional të burimeve tona të brendshme, si ato teknologjike ashtu edhe ato njerëzore.

Grupi i klientëve tanë, përbëhet nga individët, të cilët na i besojnë kursimet e tyre dhe përmbushin nevojat individuale, dhe nga kompanitë e biznesit. Klientët e biznesit janë kryesisht kompani të sukseshme të vogla e të mesme, por edhe të mëdha, të cilat kanë nevojë për rritje të mëtejshme.



# AMBIENTI MAKROEKONOMIK I EKONOMISË KOSOVARE

## 6. AMBIENTI MAKROEKONOMIK I EKONOMISË KOSOVARE

Ekonomia kosovare ende gjendet në fazën e ringjalljes dhe të rindërtimit të saj. Zhvillimi i sektorit privat është në nivel të kënaqshëm, gjithashtu sistemi bankar me Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës dhe 7 bankat komerciale ka treguar stabilitet të qëndrueshem të saj gjatë vitit 2007.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, në bazë të rritjes së ulët të produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori ndikoi në rritjen e vazhdueshme të papunësisë dhe moszgjidhjen e statusit të pensionistëve. Edhe në vitin 2007 nuk ka pasur lëvizje të ndieshme të zhvillimit ekonomik. Prodhimi i brendshëm bruto për kokë banori ishte ndër më të ultit në rajon, ndërsa përqindja e papunësisë ishte më e larta (55-60 %) me tendencë të keqësimit.

Mbulesa e importit të mallrave dhe shërbimeve me eksporte në fund të vitit 2007 ishte e ulët ( 9.3 %), për shkak të varësisë së ekonomisë kosovare nga importet, që tregon nivelin e ulët të zhvillimit global dhe struktural të ekonomisë.

Buxheti i Kosovës i formuar nga të hyrat vetanake (kryesisht nga dogana dhe taksat) në fund të vitit 2007 shenoi suficit prej 233.7 mil.EUR. Suficiti i realizuar ishte më tepër rezultat i nivelit të ulët të pagave dhe mosrritjes së tyre në sektorin e arsimit, të shëndetësisë, të policisë dhe të administratës buxhetore.

Mosaktivizimi i shumë ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara, krahas investimeve të vogla në industri e bujqësi, niveli i ulët i pagave të punëtorëve në sektorin publik, që financohet nga buxheti, sektorin privat, pensionet e ulëta në nivel të ndihmës prej 40 euro, përveç disa faktorëve të tjerë, ndikoi në rënien e vazhdueshme të aftësisë blerëse të popullsisë dhe të qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, duke vështirësuar afarizmin e bizneseve dhe duke rritur varësinë e tyre prej kredive të bankave komerciale dhe institucioneve financiare të Kosovës

## 6.1 PRODUKTI I BRENDSEHM BRUTO (GDP)

Raporti Vjetor 2007

Niveli i ulët i produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori është tregues i nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës pas luftës së vitit 1999 e deri në fund të vitit 2007 dhe krahasuar me vendet e rajonit Kosova është vendi më i pazhvilluar.

Niveli i produktit të brendshëm bruto për kokë banori në periudhën pesëvjeçare 2002-2007, ishte më i larti në vitin 2002 (1.288 EUR) ndërsa në fund të kuartalit të tretë të vitit 2007 është realizuar në shumën prej 1.150 EUR.ose për 2.9 % më i lartë se në vitin paraprak. Realizimi i produktit të brendshëm bruto në Kosovë në këtë nivel të ulët është rrjedhim i disa faktorëve kryesorë, e sidomos: i mungesës së prodhimit vendor, dhe investimeve të huaja, mospërfundimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore e mosaktivizimit të shumë ndërmarrjeve të privatizuara, rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare dhe moszgjidhjes së statusit të Kosovës gjer në fund të vitit 2007. Në formimin e produktit të brendshëm bruto më së shumti kanë ndikuar tre faktorë: importet, asistenca e huaj dhe dërgimi i mjeteve:

PSHKRIMI/PERIUDHA	2002	2003	2004	2005	2006	2007
GDP(në mil.euro)	2.447	2.420	2.282	2.238	2.270	2.378
GDP për banorë(ne euro)	1.288	1.252	1.161	1.120	1.117	1.150
Dërgesat e punëtorëve(në mil.eur)	341	341	215	281	318	398
Ndihma nga jashtë(në mil.euro)	887	688	565	491	465	352
Popullsia(ne 000)	1.900	1.932	1.965	1.999	2.015	2.063

## 6.2 TREGTIA E JASHTME

Gjatë vitit 2007 kanë vazhduar aktivitetet më të mëdha në import se në eksport të mallrave dhe të shërbimeve. Shuma e përgjithshme e importit prej 1.5 miliard EUR në fund të vitit 2007 ishte më e lartë për 269.7 mil.EUR se në fund të vitit 2006, ose për 20.65 %. Ndërsa, shuma e përgjithshme e eksportit në fund të vitit 2007, prej 146.6 mil.EUR ishte më e lartë se në fund të vitit 2006 për 35.8 mil.EUR, ose për 32.3%.

Për shkak të rritjes së eksportit në fund të vitit 2007, është rritur edhe mbulesa e importit me eksport nga 4,1% në fund të vitit 2005, në 6,0% në fund të vitit 2006 , në fund të vitit 2007 në 9.3% ,ndërsa deficiti i bilancit tregtar nga 1.1 miliard EUR në 1.2 miliard EUR në 2006, ndërsa në 1.4 miliard EUR në fund të vitit 2007.

## 6.3 INFLACIONI

Inflacioni, nëpërmes çmimeve me pakicë, ka shënuar rritje të ulët, nga viti 2002, kur ka filluar të llogaritet inflacioni pas luftës së vitit 1999. Rritja më e lartë është shënuar në fund të vitit 2003 për 3,7%, ndërsa në fund të vitit 2005 është për 2,8%, në fund të vitit 2006 për 3.9 % dhe në fund të vitit 2007 për 10.6% .

Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe të shërbimeve.

---

2Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/08

3Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/08

## 6.4 SISTEMI BANKAR

Raporti Vjetor 2007

Sistemi bankar i Kosovës përbëhet prej 7 bankave komerciale të nivelit të dytë dhe 237 degëve e nëndegëve në tërë territorin e Kosovës. Të gjitha bankat komerciale selinë e kanë në Prishtinë, ndërsa degët e tyre janë të hapura në shtatë qendrat kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj.

Bankat me degët dhe nëndegët e tyre janë të licencuara nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, në mbështetje të Rregullores për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave të vitit 1999.

Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme.

PËRSHKRIMI/PERIUDHA	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Depozita	427.194	514.045	692.296	838.584	923.260	1,111.234
Kredi	86.498	232.773	373.668	492.079	576.912	819.506
% kredi/depozita	20.2	45.3	53.9	58.7	62.5	73.75
Fitimi neto	2.716	6.801	10.349	13.229	19.297	33.780

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2007 është më e lartë për 160,1% në krahasim me vitin 2002 dhe për 20.4% në krahasim me vitin 2006. Rritja e depozitave prej vitit në vit është rrjedhim i rritjes së besimit të klientëve(kursimtarëve) në bankat komerciale, si rezultat i likuiditetit të lartë dhe të qëndrueshëm bankar. Pjesëmarrja e shumës së përgjithshme të kredive (portofolio neto) në shumën e depozitave është rritur nga 20.2% në fund të vitit 2002 në 73.75% në fund të vitit 2007.

---

4 Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" janar/08

5 Shenimet e publikuara të bankave komerciale në gazetatat e përditshme



**VËSHTRIM MBI AFARIZMIN E BANKËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2007**



**Banka  
Ekonomike**

H/M

M/T

M/W



Banka Ekonomike, në fund të vitit 2007, ka realizuar shumën e aktivës me 56.0 mil.euro dhe shumën e përgjithshme të bilancit me 61.2 mil.euro, duke përfshirë zërat jashtëbilancorë. Në krahasim me vitin 2006, shuma e përgjithshme e aktivës ishte më e lartë për 10.4% dhe shuma e bilancit për 12.9%. Fitimi i përgjithshëm neto në vitin 2007 ishte 18.374,00 EUR.

Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2007 (numri i llogarive të klientëve, depozitat dhe kreditë) ishin mbi nivelin e vitit paraprak.


## 7.1 NUMRI I LLOGARIVE TË KLIENTËVE

Numri i llogarive të klientëve të Bankës Ekonomike ka shënuar rritje të vazhdueshme prej viti në vit dhe në fund të vitit 2007 është rritur në 47.499, me këtë strukturë:

<b>Përshkrimi Viti</b>	<b>2002</b>	<b>%</b>	<b>2003</b>	<b>%</b>	<b>2004</b>	<b>%</b>	<b>2005</b>	<b>%</b>	<b>2006</b>	<b>%</b>	<b>2007</b>	<b>%</b>
Persona juridik	1.042	7.6	1.160	8.6	2.466	8.9	3.085	9.1	3.644	8.7	4.119	8.7
Persona fizik	12.702	92.4	17.589	91.4	25.743	91.1	31.020	90.9	38.421	91.3	43.380	91.3
Gjithsej:	13.744	100	19.249	100	27.809	100	34.105	100	42.065	100	47.499	100

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2007 është rritur për 12.9% në krahasim me vitin e kaluar.

Numri i llogarive të klientëve



Llogaritë e klientëve të hapura në Bankën Ekonomike janë të personave juridikë dhe individualë, vendasë dhe të huaj. Llogaritë e personave individualë marrin pjesë me 91.3% në numrin e përgjithshëm të llogarive në fund të vitit 2007.

Në kuadër të llogarive të personave individualë, 32.406 u përkasin llogarive për pagesën e pagave dhe të pensioneve.


Llogaritë e klientëve sipas degëve të Bankës, më së shumti u hapën në degën: Prishtinë (12.094), Gjakovë (10.159), Pejë (9.845), Prizren (6.420) dhe Mitrovicë (4.544). Ndërsa dega në Gjiatë me 2.677 llogari dhe në Ferizaj me 1.760 llogari, marrin pjesë më 9.3% në numrin e përgjithshëm të llogarive të klientëve.

Banka Ekonomike ka arritur sukses dhe rritje të konsiderushme në financimet e sektorëve si: për bizneset e vogla, për bizneset e mesme dhe për personat fizikë.  
Struktura e kredive është si në vijim:

Kreditë e dhëna për bizneset e Vogla- kanë patur një rritje stabile nga viti në vitë, kështuqë në dhjetor të vitit 2004 mbetja e kredive arrinte në shumën prej: 643,847.06 €, kurse në fund të viti 2007 mbetja e kredive për këtë kategori është në shumë prej: 1,002,546.03 €.

Grafikoni 1. Paraqitja grafike e kredive për bizneset e vogla


Kredi për Bizneset e vogla



Kreditë e dhëna për bizneset e mesme – është kategoria që në çdo periudhë ka pasur nivel më të madh të përqindjes në krahasim me portofolion kreditorë. Në dhjetor të vitit 2004 mbetja e kredive të kësaj kategori arrinte shumën prej: 14,471,137.00 €, ndërsa në dhjetor të vitit 2007 vlera e kredive të mbetura për këtë kategori arrinte shumën prej: 26,726,183.35 €.

## Grafikoni 2. Paraqitja grafike e kredive për bizneset e mesme


Kredi për Bizneset e mesme



Kredit e dhëna për personat fizikë- kanë shënuar rritje nga viti në vit. Në vitin 2004 mbetja e kredive arrinte në vlerën e mbetur në shumë prej: 1,754,476.54 €. Kurse vlera e mbetur e kredive për personat fizik për vitin 2007 është: 3,998,839.92 €.

## Grafikoni 3. Paraqitja grafike e kredive për personat fizik

Kredi për personat fizik




Banka Ekonomike në fund të vitit 2007 realizoi shumën e përgjithshme të depozitave prej 44.5 mil. EUR, përkatësisht për 2.8% më shumë se në vitin e kaluar, më këtë strukturë:

Përshkrim/Viti	2002	%	2003	%	2004	%	2005	%	2006	%	2007	%
Depozita me afat	5.934	45.5	12.778	59.3	21.414	68.5	27.695	71.4	29.748	68.7	31.891	71.7
Depozita pa afat	7.119	54.5	8.783	40.7	9.865	31.5	11.066	28.6	13.540	31.3	12.614	28.3
Gjithsej:	13.053	100	21.561	100	31.279	100	38.861	100	43.288	100	44.505	100

Rritja e pjesëmarrjes së depozitave me afat në shumën e përgjithshme të depozitave, prej viti në vit, ka rezultuar shtimin e besimit të kursimtarëve në Bankën Ekonomike dhe krijimin e kushteve për një politikë stabile kreditore. Ndërsa, rritja e shumës së përgjithshme të depozitave ka ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shumën e përgjithshme të depozitave në nivel të bankave komerciale në Kosovë nga 4.1% në vitin 2003, në 4.5% në vitin 2004, në 4.6% në vitin 2005, në 4.7% në vitin 2006, ndërsa 4.01 në fund të vitit 2007. Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2007 ka patur këtë përbërje:

Përbërja e shumës së përgjithshme të depozitave në mil.Euro në fund të vitit 2007

Numri i llogarive të klientëve



	Current accounts	Term deposits
Individual <span style="color:red">■</span>	6,8	15,7
Juridik <span style="color:grey">■</span>	5,8	16,2
Total <span style="color:purple">■</span>	12,6	31,9

## 7.4 LANSIMI I PRODUKTEVE TË REJA

Raporti Vjetor 2007

Gjate vitit 2007 janë lansuar këto produkte të reja:

1. Llogaritë e kursimit  
për individ  
për fëmijë
2. Kreditë Ekspres
3. Kreditë private
4. Kreditë kosumuese ( BEK Partner )
5. Mbitërheqje për individë
6. Kredi për Bujqësi
7. BE-SMS Banking




## 7.5 THESARI

Departamenti i Thesarit është i përqëndruar në menaxhimin e likuiditetit, këmbimet me valutat e huaja, plasimin e fondeve ne bankat korrespondente, dhe menaxhimin e riskut të normës së interesit.

Roli i Departamentit të Thesarit me kalimin e kohës është duke u bërë më i rëndësishëm dhe më strategjik dhe është duke ndërmarrë më tepër iniciativa që e zhvillojnë më shumë performancën e biznesit . Roli i thesarit po ashtu është duke u zgjeruar dhe duke luajtur rolin kryesor në lëmi të tjera, siç janë menaxhimi i kapitalit dhe menaxhimi i riskut.


## 7.6 QARKULLIMI I PAGESAVE

Arritjet ne pagesat e brendshme dhe të jashtme e mbyllën me sukses vitin 2007, ku shënuan rritje të dukshme.



Vlerat ne miliona EUR

Qarkullimi i pagesave të brendshme ne mes klientëve të bankave komerciale përmes AQBK-së (kliringu), është në rritje të vazhdueshme prej vitit në vit dhe në fund të vitit 2007 ka arritur shumën prej 152.3 mil.EUR. Nga kjo shumë, 60.6 mil.EUR janë realizuar përmes transfertës hyrëse të mjeteve për 14.044 transaksioneve. Ndërsa, pjesa tjetër e shumës prej 91.7 mil.EUR është realizuar përmes transfertës dalëse të mjeteve për 16.845 transaksione.



Vlerat ne miliona EUR

Qarkullimi i pagesave me botën (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit) në vitin 2007 është realizuar në shumën prej 128.6 mil.EUR. Nga kjo shumë, 65.3 mil.EUR janë realizuar përmes transfertës hyrëse të mjeteve për 1.643 transaksioneve. Ndërsa, pjesa tjetër e shumës prej 63.2 mil.EUR është realizuar përmes transfertës dalëse të mjeteve për 4.226 transaksione nëpërmes të tri bankave korrespondente:

LHB Iternacionale Handelsbank, Frankfurt, Gjermani


RZB Raiffaisen Zentralbank Oesterich AG, Vjenë, Austri

BASH Banka Amerikane e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

## Letër kreditë

Letër kreditë vitin 2007 e përfunduan me rezultate të larta dhe të sukseshme.

LetërKreditë 2007




LetërKreditë sipas vlerave

## Garancionet

Gjatë vitit 2007 Garancionet shënuan rritje të theksuar. Kjo rritje sipas vlerës dhe numrit është e paraqitur në grafikon si me poshte.

Garancionet 2007





## 7.7 MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Gjatë vitit 2007 është bërë ndarja e Departamentit të Kreditimit, në Departamentin e Riskut dhe Departamentin për Zhvillimin e Biznesit. Qëllimi i ndarjes është bërë për rritjen e efikasitetit të punës për lëshimin e kredive, si dhe për sistem sa më të mirë të kontrollës.

Departamenti i Riskut ka qenë i orientuar në zhvillimin e analizës financiare në mënyrë që lëshimi i kredive të jetë sa më efikas dhe më i sigurt. Në të njëjtën kohë për implementimin e ri të procedurës së analizës financiare janë mbajtur trajnime të analizës financiare për të gjitha degët dhe trajnime ka qenë i dedikuar për analistët kreditorë, koordinatorët dhe drejtorët e degëve.

Në të ardhmën parashikohen të mbahen trajnime shtesë për analistë kreditorë me qëllim të përmirësimit të analizës kreditore, si dhe do të mbahen trajnime për analistët e ri kreditorë.

Departamenti i Riskut gjatë vitit 2007 ka bërë përmirësimin e politikës dhe procedurave kreditore dhe njëkohësisht ka bërë implementimin e 9 shtojcave të politikës kreditore si dhe ka modifikuar aplikacionet e reja kreditore. Poashtu është bërë Politika dhe procedura për riskun kreditor, dhe bërë implementimi i metodologjisë së re për klasifikimin e kredive, duke u bazuar në rregullën IX të AQBK-se, ndërsa gjatë këtij viti prioritet do të jetë edhe metodologjia e klasifikimit të kredive sipas rregullës IFRS.

Menaxhimi i riskut kreditor ka qenë përgjegjësia kryesore e Departamentit të Riskut, ndërsa implementimi i procedurave të reja është bërë me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të riskut.

Në Bankën Ekonomike gjatë vitit 2007 me ardhjen e menaxhmentit të ri ekzekutiv është bërë ndryshimi dhe riorganizimi i strukturës organizative të Bankes Ekonomike, ku si rezultat është themeluar edhe Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Ky departament së pari është përqëndruar në rekrutimin e punëtorëve kompetentë për t'i plotësuar pozitat specifike në bankë, ku edhe i është dhënë mundësia një numri të madh të punëtorëve që të avansohen në pozita të reja duke u bazuar në aftësitë dhe shkathhtësitë e tyre. Gjatë kësaj periudhe është rritur numri i të punësuarve për 17.5 %.

Krahas kësaj është punuar për zhvillimin e procedurave dhe të politikës së burimeve njerëzore të cilat mundësojnë funksionimin adekuat të këtij Departamenti. Gjithashtu, rëndësi të veçantë i është kushtuar identifikimit të nevojave të punëtorëve për trajnime shtesë, si rezultat i kësaj periudhe punëtorët janë trajnuar në fusha të ndryshme bankare nga ana e Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe trajnuesve të brendshëm.

## 7.9 ZGJERIMI I DEGËVE DHE MODERNIZIMI I TYRE

Banka Ekonomike që nga liçencimi në vitin 2001 e deri në fund të vitit 2007, ka zgjeruar rrjetin e saj në 30 njësi punuese, duke përfshirë degët, nëndegët dhe zyrat bankare të saj. Investimet e Bankës Ekonomike në vitin 2007 u fokusuan në zgjerimin e prezencës së degëve dhe nëndegëve, si dhe në gamën e produkteve dhe shërbimeve bankare .

Vëmendje e veçantë i është kushtuar përcaktimit dhe implementimit të standardit për enterier dhe eksterier të Bankës dhe të degëve të saj, jo vetëm në pikat e reja të hapjes, por edhe në ato ekzistuese. Standardet e përcaktuara ofrojnë mundësi më të mirë komunikimi në mes të punësuarve dhe të klientëve, si dhe identifikim më të lehtë dhe të shpejtë të Bankës.

Në kuadër të planit të zgjerimit të prezencës së vet , Banka Ekonomike ka hapur tri nëndegë të reja, së pari në lagjen Ulpiana – Prishtinë, pastaj është hapur nëndega në Junik –Pejë, dhe së fundi në Dhjetor 2007 është hap nëndega në lagjen Kodra e Trimave - Prishtinë, duke ju ofruar edhe një mundësi më shumë klientëve dhe qasje sa më të shpejtë në shërbimet e saj bankare.

Gjatë vitit 2008 investimet do të orientohen në modernizimin e degëve ekzistuese në qytetet Prishtine, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan. Ndërsa zgjerimi i degëve dhe nëndegëve të reja po me të njëjtat standarde të përcaktuara gjatë vitit 2007 do të bëhet në qytetet Podujevë, Vushtri, dhe Klinë





# PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT

**Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit  
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor të vitit 2007**

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	28
BILANCI I GJENDJES	30
PASQYRA E TË ARDHURAVE	31
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR	32
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	33
SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE	35-73

Për aksionarët e Banka Ekonomike Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Ekonomike Sh.a (“Banka”) ku përfshihen bilanci igjendejs deri më 31 Dhjetor 2007 si dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për fund vitin 2007, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënime të tjera. Pasqyrat Financiare të Bankës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006, janë audituar nga auditor të tjerë, raporti i të cilëve është lëshuar më 27 Prill 2007, që kanë shprehur opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare për arsye të kufizimit të fushëveprimit lidhur

me njohjen e provizionimit të kredive në përputhshmëri me IAS 39, të hyrat e komisioneve dhe të tarifave nga aktivitetet e kreditimit dhe keqpërdorimin e kesh-it.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezentimin e pasqyrave financiare në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“IFRS”). Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollave relevante për përpilimin dhe prezentimin e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë gabime materiale, nga cila do arsyje, e gabimit me qëllim apo pa qëllim, përzgjedhja dhe aplikimi i politikave të duhura të kontabilitetit, si dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Përgjegjësitë e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim lidhur me pasqyrat financiare bazuar në auditimin e bërë. Ne kemi kryer auditimin në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin në mënyrë që të përfitojmë një siguri racionale nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin performimin e procedurave për marrjen e dëshmimeve audituese lidhur me shumën dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e selektuara për auditim varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut për gabime materiale në pasqyrat financiare, të bëra me apo pa qëllim. Në vlerësimin e rreziqeve, auditori merr parasysh kontrollat e brendshme relevante në përpilimin dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të dizajnojë procedurat e auditimit që të jenë ato të duhurat në rrethana të caktuara, por jo për të shprehur një mendim lidhur me efektivitetin e kontrollave të brendshme të Bankës. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e politikave të duhura të kontabilitetit të përdorura si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin dhe prezentimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Përveç bazës së kualifikimit të opinionit të përshkruara në paragrafet 1 dhe 2 mëposhtë, ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të ofruar baza për opinionin tonë.

## Bazat për opinionin e kualifikuar

1. Siç është përshkruar në notën 6 të pasqyrave financiare, Banka ka kalkuluar provizionimin e humbjeve nga kreditë dhe avanseve ndaj klientëve për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006 duke përdorur një metodë të kalkulimit, e cila në opinionin tonë, nuk është në përputhshmëri me IAS 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja”, ndërsa për vitin 2007 Banka ka kalkuluar provizionimin e humbjeve nga kreditë në përputhshmëri me IAS 39. Pasi gjendja fillestare e provizionimit të humbjeve nga kreditë hyn në determinimin e rezultateve të operimeve për vitin 2007, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse rregullimet (përmirësimet) në pasqyrën e të ardhurave dhe gjendjen fillestare të fitimit të mbajtur, janë të nevojshme si me 31 Dhjetor 2007 dhe për vitin 2007.

2. Siç është përshkruar në notën 3 (f) të pasqyrave financiare, Banka njehtë hyrat nga tarifat dhe komisionet aktivitetet kredituese në baza të keshit për shkak të limitimeve që sjell sistemi I teknologjisë informative. Këto të hyra nga tarifat dhe komisionet prej 407 mijë Euro për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2007 (2006: Euro 371 mijë) paraqet tarifat bazë të kredive, të cilat janë në përputhje me IAS 18 “Të ardhurat”, dhe sëbashku me shpenzimet direkte, duhet të shtyhen dhe njohen si korrigjime të normës së interesit efektiv të instrumentit përkatës. Si rezultat i kësaj më lartë, dhe në mungesë të kalkulimeve adekuate nga Banka për shumën e këtyre tarifave për tu shtyer në vitet e ardhshme, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë shumën nga e cila kreditë dhe avanset ndaj klientëve si me 31 Dhjetor 2007 dhe 2006 dhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet për vitet që kanë përfunduar janë mbiçmuar ose nënvlerësuar.

### *Opinionin*

Në opinionin tonë, përveç efekteve të rregullimeve të tilla, nëse ka ndonjë, që mund të jenë gjetur që janë të nevojshme për të bindur vetën tonë, për çështjet e treguara në paragrafin 1 dhe 2 si mësipër, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës si më 31 Dhjetor 2007, dhe performancën financiare si dhe rrjedhjen e parasë për vitin e përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“IFRS”).



Deloitte Kosova Sh.p.k

Prishtina, Kosovo

15 Maj 2008

## BILANCI I GJENDJES, SI ME 31 DHJETOR 2007

	Shënim	Si me 31 Dhjetor 2007 (in Euro 000')	Si me 31 Dhjetor 2006 (in Euro 000')
<b>PASURIA</b>			
Paraja në dorë dhe në banka	4	19.251	23.297
Balancat me AQBK-në	5	3.628	4,329
Kreditë e dhëna klientëve	6	31.316	21,136
Investimet në pasuri	7	420	443
Patundshmërit, impiantet dhe paisjet	8	981	1,021
Pasuria e paprekshme	9	87	108
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e Korporates	17	125	-
Pasuria tjetër		495	386
<b>Gjithsej pasuria</b>		<b>56.303</b>	<b>50.720</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Depozitat e klientëve	10	45,008	43,913
Tatimi në të hyrat e Korporatës   pagueshëm	17	-	82
Llogaritë e pagueshme	11	128	105
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>45,136</b>	<b>44,100</b>
<b>KAPITALI AKSIONAR</b>			
Kapitali aksionar	12	10,746	4,725
Rezerva gjenerale e riskut	13	102	102
Fitimi i akumuluar		319	1,793
<b>Gjithsej kapitali aksionar</b>		<b>56.303</b>	<b>50.720</b>
<b>Gjithsej kapitali aksionar</b>		<b>11.167</b>	<b>6,620</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar</b>		<b>56.303</b>	<b>50,720</b>

Autorizuar për lëshim nga menaxhmenti më 15 Maj 2008.



**Valon LLUKA**  
Drejtor i përgjithshëm



**Syzane KAQANIKU**  
Drjetoresh Financiare

Shënimet nga faqja 35 deri 73 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.



**Të hyrat nga interesi:**

	Shënim	2007 (në Euro 000)	2006 (në Euro 000)
Nga kreditë e dhëna klientëve		3,119	3,012
Nga depozitat dhe balancat me bankat		792	424
<b>Gjithsej të hyrat nga interesi</b>		<b>3,911</b>	<b>3,437</b>
Shpenzimet e interesit në detyrimet nga kostoja e amortizimit		(1,181)	(1,094)
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>		<b>2,730</b>	<b>2,343</b>
Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	14	1,367	1,429
Shpenzimet nga komisionet dhe tarifat		(106)	(88)
<b>Të hyrat neto nga komisionet dhe tarifat</b>		<b>1,261</b>	<b>1,341</b>
Të hyrat tjera operuese	15	709	134
Humbjet neto nga valutat e huaja		(77)	(63)
<b>Gjithsej të hyrat</b>		<b>4,623</b>	<b>3,755</b>
Shpenzimet e tjera operuese	16	(2,910)	(2,673)
Provizionimi për humbjet nga kreditë	6	(1,388)	(293)
<b>Gjithsej shpenzimet operuese</b>		<b>(4,298)</b>	<b>(2,966)</b>
<b>Fitimi para tatimit të të hyrave</b>		<b>325</b>	<b>789</b>
Shpenzimet e tatimit të të hyrave	17	(6)	(158)
<b>Fitimi neto per vitin</b>		<b>319</b>	<b>631</b>

Shënimet nga faqja 35 deri 73 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

**Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar**

Si me 31 Dhjetor 2007

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Rezerva gjenerale errezikut</b>	<b>Fitimi i mbajtur</b>	<b>Gjithsej kapitali aksionar</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2006</b>	4,725	102	1,162	5,989
Neto fitimi për vitin	-	-	631	631
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2006</b>	<b>4,725</b>	<b>102</b>	<b>1,793</b>	<b>6,620</b>
Kapitalizimi i fitimit (shënimi 12)	1,793	-	(1,793)	-
Rritja në kapitalin aksionar	4,228	-	-	4,228
Neto fitimi për vitin	-	-	319	319
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2007</b>	<b>10,746</b>	<b>102</b>	<b>319</b>	<b>11,167</b>

*Shënimet nga faqja 35 deri 73 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.*

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë**

Si me 31 Dhjetor 2007

Shënim	2007 (në Euro 000')	2006 (në Euro 000')
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operuese</b>		
<b>Fitimi për vitin</b>	325	789
Rregullimet për njësitë jo-kesh:		
Zhvlerësimi	291	248
Amortizimi	18	38
Humbjet neto në kredi dhe avanse	1,388	293
Humbjet nga heqjet prej përdorimit të paisjeve dhe pronës	–	6
Shpenzimet e interesit	1,181	–
Të hyrat nga interesi	(3,915)	(2,343)
	<b>(712)</b>	<b>(969)</b>
Ndyshimet në balancat e kufizuara meAQBK	701	(693)
Zvogëlimet në kredi dhe avanse me bankat	–	2,500
Rritjet në kredi dhe avanse për klientë	(11,565)	(210)
Ndryshimet në investimet në pasuri	–	(460)
Ndyshimet në pasurinë tjetër	(109)	(327)
Zvogëlimet në depozitat nga bankat	–	(2,503)
Rritjet në depoziat nga klientët	1,095	7,027
Rritjet/zvogëlimet në detyrimet tjera	23	(38)
	<b>(10,567)</b>	<b>4,327</b>
Tatimi në të hyra I paguar	(213)	(104)
Interesi I paguar	(1,181)	(845)
<b>Neto kesh-i nga aktivitetet operuese</b>	<b>(11,961)</b>	<b>3,378</b>

Shënimet nga faqja 35 deri 73 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

<b>Notat në pasyrtat financiare</b>				
Si me 31 Dhjetor 2007		<b>Shënim</b>	<b>2007</b> (në Euro 000')	<b>2006</b> (në Euro 000')
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investive</b>				
Të hyrat nga shitja e pasurisë			10	-
Blerjet e pasurisë dhe paisjeve		8	(238)	(119)
Blerjet e pasurisë së paprekshme			-	(6)
Interesi I arkëtuar			3,915	3,393
<b>Neto keshi nga aktivitetet investive</b>			<b>3,687</b>	<b>3,268</b>
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese</b>				
Të hyrat nga lejimi I kapitalit			4,228	-
<b>Neto keshi nga aktivitetet financuese</b>			<b>4,228</b>	-
<b>Neto rritjet në kesh dhe ekuivalentët e keshit</b>			<b>(4,046)</b>	<b>6,646</b>
Keshi dhe ekuivalentët e keshit me 1 Janar			23,297	16,651
<b>Keshi dhe ekuivalentët e keshit me 31 Dhjetor 2007</b>		4	<b>19,251</b>	<b>23,297</b>

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2007

## 1. TË PËRGJITHSHME

Në përputhshmëri me rregulloret e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (“AQBK”), më herët e njohur si Autoriteti Bankar i Pagesave të Kosovës, Banka Ekonomike Sh.a. Prishtinë (“Banka”) morri licencën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 Maj 2001 dhe filloi operimin e saj më 5 Qershor 2001. Zyra qendrore të Bankës gjendet në Rr. Migjeni Nr.1, Prishtinë, Kosovë. Banka operon njëkohësisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

## 2. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË KORIGJUARA

### 2.1 Standardet dhe Interpretimi efektiv në periudhën e tanishme

Në vitin aktual, Banka ka adoptuar IFRS 7 Instrumentet Financiare: Shpalosjet e të cilit janë efektive për raportim vjetor për periudhat duke filluar nga apo pas 1 Janar 2007, dhe amandamentet vijuese të IAS 1 Prezentimi i Pasqyrave Financiare. Ndikimi i adaptimit të IFRS 7 si dhe ndryshimet në IAS 1 janë bërë për të zgjeruar shpalosjet e prezentuara në pasqyrat financiare lidhur me instrumentet financiare dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

### 2.2 Standardet dhe Interpretimet që janë lëshuar por ende nuk kanë efekt:

Deri në datën e autorizimit për lëshim të këtyre pasqyrave financiare, standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por ende nuk kanë efekt:

- IFRS 2 Pagesat e bazuara në aksione, Amandamenti lidhur me kushtet përkatëse dhe anulimet (periudha efektive vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IFRS 3 Ndërthurje Biznesore, rishikim gjithëpërfshirës në aplikimin e metodës të vlerësimit (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IFRS 8 Segmentet Operative (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IAS 1 Prezentimi i Pasqyrave Financiare, rishikim gjithëpërfshirës duke përfshirë kërkesën mbi pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IAS 23 (Rishikim) Kosto e Huasë (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IAS 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të ndara, amandamentët përkatëse që rrjedhin nga amandamenti IFRS 3 (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)

- IAS 28 Investimet me Ortakëri, amendmentët përkatëse që rrjedhin nga amendmenti IFRS 3 (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IAS 31 Interesi në bashk-sipërmarrje amendmentët përkatëse që rrjedhin nga amendmenti IFRS 3 (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IAS 32 Instrumentet Financiare: Prezentimi,, Amendamentët që kanë të bëjnë me instrumentët e vendosshme dhe obligimet që lidhen me likuidimin (efektive për periudhën vjetore që fillon me ose pas 1 Janarit 2009)
- IFRIC 13 Programe mbi Besnikërinë e Klientëve (efektive për periudhën e kontabilitetit që fillon me ose pas 1 Korrik 2008)
- IFRIC 11 IFRS 2: Transaksione me Aksione të Thesarit dhe Grupore (efektive më 1 Mars 2007)
- IFRIC 12 Marrëveshjet për Lëshim të Shërbimeve (efektive më 1 Janar 2008)

## 2. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË KORIGJUARA (VAZHDIM)

### 2.2 Standardet dhe Interpretimet që janë lëshuar por ende nuk kanë efekt (vazhdim)

- IFRIC 14 IAS 19 - Limiti në Asetet Përfituese të Definuar, Kërkesat Minimale për Financim dhe Bashkëveprimet e tyre (efektive më 1 Janar 2008).

Menaxhmenti parashikon që adaptimi i këtyre standardeve dhe interpretimi i tyre në të ardhmen nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Bankës.

## 3. POLITIKAT BAZË KONTABILE

### a) Pasqyrat e përputhjeve

Pasqyrat financiare janë përpiluar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Standards.

### b) Bazat e përpilimit

Pasqyrat financiare janë përpiluar sipas parimit të kostos historike përveç për rivlerësimin e pasurisë jo rrjedhëse dhe intrumenteve financiar. Politikat bazë kontabile janë përshkruar më poshtë.

### **c) Valuta e prezentimit**

Valuta e prezentimit të Bankës është në Euro, e cila është valutë e vendit (legale) në tërë Territorin e Kosovës prej 1 Janar 2002.

### **d) Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve**

Të hyrat nga interesi dhe shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet bartëse në baza akruale duke përdorur metodën efektive të të ardhurave duke u bazuar në çmimin blerës të tanishëm përveç kredive që bëhen të dyshimta lidhur me mbledhjen e të hyrave nga interesi që njihet në baza të arkëtimit.

### **e) Rezervat e detyrueshme të likuiditetit**

Në përputhshmëri me rregulloret e AQBK-së, Banka duhet të përmbush mesataren e minimumit të kërkuar të likuiditetit. Kërkesat e likuiditetit kalkuloohen në baza mujore si 10% e depozitave bazë, e definuar si mesatare e gjithsej depozitave të sektorit jo-bankar publik në Euro si dhe valutave tjera. Asetet me të cilat Banka mund të arrijë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në Euro me CBAK-në dhe 50% të ekuivalentëve të Euro-s të parasë së gatshme të denominuar në valuta të konvertueshme. Depozitat me AQBK-në nuk duhet të jenë më të vogla se 5% nga baza e depozitave. Pasi që mjetet likuide nuk janë të disponueshme në aktivitetin ditor të Bankës, janë larguar nga keshi dhe ekuivalentët e keshit për arsye të rrjedhjes së parasë.

### **f) Të hyrat nga tarifat dhe komisionet**

Të hyrat nga tarifat dhe komisionet nga aktiviteti i kreditimit njihet kur të pranohet keshi.

Të hyrat e tjera nga tarifat dhe komisionet, përfshirë tarifat e shërbimeve, komisionet e shitjes, tarifat e afatizimeve, njihen kur shërbimet e ngjashme kryhen.

### **g) Asetet financiare**

#### *I) Klasifikimi*

Kreditë bazë dhe arkëtimet përbëhen nga kreditë dhe avanset ndaj klientëve dhe institucionet kreditore dhe kreditë ndaj punëtorëve.

#### *iii) Njohja*

Mbajtja në maturim e aseteve dhe kredive bazë dhe arkëtimeve njihen në ditën kur keshi disbursohet nga Banka.

#### *iii) Matja*

Instrumentet financiare maten fillimisht nga kosto, duke përfshirë kostot e transaksioneve. Të gjitha kreditë dhe të arkëtueshmet dhe mbajtja në maturim e aseteve maten në koston e amortizimit pa humbjet e kredive nëse ka ndonjë. Kosotoja e amortizimit kalkulohet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Premiumet dhe zbritjet, përfshirë kosotot e transaksionit, janë përfshirë në shumën bartëse të instrumentit dhe amortizimit bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, atëherë kur aplikohet.

Metoda efektive e interesit është metodë e kalkulimit të koston së amortizimit të asetit financiar dhe të hyrave nga alokimi i interesit për periudhën relevante. Norma efektive e interesit është normë që në mënyrë të saktë zbrret arkëtimet e përfaqëta në të ardhmen (përfshirë të gjitha tarifatat në pikat e pagesës ose pranuar nga forma integrale e normës efektive të interesit, koston së transaksionit dhe premiumeve tjera apo zbritjeve) përmes jetëgjatësisë së pritshme të asetit financiar apo, ku aplikohet, periudhë më e shkurtër.

#### *iv) Instrumentet specifike*

#### *Keshi dhe ekuivalentët e keshit*

Keshi dhe ekuivalentët e keshit janë njësi të cilat mund të konvertohen në kesh në një kohë të shkurtër dhe që janë subjekt i një rreziku signifikant të ndryshimeve të vlerës. Shumat që kanë të bëjnë me fondet që janë të kufizuara janë larguar nga keshi dhe ekuivalentët e keshit.

#### *Investimet e mbajtura në maturim*

Investimet e mbajtura në maturim, janë depozita të investimit me bankat korrespondente. Ato janë të klasifikuara si asete të mbajtura në maturim.

#### *Kreditë dhe avanset e klientëve*

Kreditë dhe avanset të dhëna nga Banka janë të klasifikuara si kredi dhe të arkëtueshme. Kreditë dhe avanset raportohen si neto e lejimeve për provizionimin e kredive që reflektojnë shumatat e vlerësuarat të kthimit.

#### *v) Mosnjohja*

Një aset financiar nuk njihet nga Banka atëherë kur Banka humb kontrollin lidhur me të drejtat e kontraktimit nga ai aset. Kjo ndodh kur të drejtat realizohen, skadohen. Një detyrim financiar nuk njihet nga Banka atëherë kur asgjësohet. Banka përdorë një metodë specifike të identifikimit për njohjen e fitimit apo humbjes kur bëhet heqja nga përdorimi. Kreditë dhe të arkëtueshmet nuk njihen atëherë kur ato i ripaguhet Bankës.



## 3.POLITIKAT BAZË KONTABILE (VAZHDIM)

### g)Asetet financiare (vazhdim)

#### *vi) Dëmet dhe mosmbledhja e asetëve financiare*

Një vlerësim bëhet në cdo datë të bilancit të gjendjes për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që asetit financiar apo grupe të asetëve financiare mund të humben. Nëse ka ndonjë evidencë të tillë, shuma e përafërt e rikuperueshme dhe ndonjë dëm nga humbjet të atij asetit është përcaktuar, bazuar në vlerën e tanisme në neto të rrjedhjes së parasë së parashikuar, dhe njihet për dallim në mes të shumës së rikuperueshme dhe shumës bartëse si në vazhdim:

Për kreditë bazë nga Banka – kreditë dhe avanset ndaj klientëve raportohen në neto kosto të amortizimit të provizionimit (lejimet) që pasqyrojnë shumat e përafërta të rikuperueshme. Rreziku kreditor i provizionimit për dëmin nga kreditë formohet nëse ka ndonjë evidencë objektive që banka nuk do të mund të mbledh shumat e duhura sipas konditave origjinale kontraktuese. Shuma e provizionimit është diferenca në mes shumës bartëse dhe shumës së përafërt rikuperuese, që kalkulohet si vlerë e tanishme e rrjedhjes së parasë së prititur përfshirë shumat e rikuperueshme nga garancionet dhe kolaterali, zbritur tarifën efektive të interesit të instrumentit.

Lejimet janë bërë përkundër shumës bartëse të kredive dhe avanseve që janë identifikuar të jenë dëmtuara, bazuar në rishikimet e rregullta të shumave të mbetura për të zbritur këto kredi dhe avanse ndaj shumave të tyre të rikuperueshme. Lejimet për dëmet nga kredia gjithashtu mbulojnë humbjet atëhere kur ka evidencë objektive që humbjet e mundshme janë prezente në komponentet e portfolios së kredisë në datën e bilancit të gjendjes. Këto janë parallogaritje bazuar në modelet e mëparshme të humbjeve në çdo komponentë dhe rangimet kreditore ndaj huamarrësve pasqyrojnë mjedisin e tanishëm ekonomik në të cilin huamarrësit operojnë.

Kur një kredi konsiderohet e pambledhëshme, ajo shlyhet përkundër provizionimit për dëmtim të kredisë. Kreditë e tilla shlyhen pasi që të gjitha procedurat e nevojshme janë kryer dhe shuma e humbjes është e përcaktuar. Rimarrjet e ardhshme të shumave që më herët janë shlyer kreditohen në pasyrën e të ardhurave.

Nëse shuma e provizionimit për dëmin e kredisë më pas zvogëlohet për arsye që mund të ndodhin pasi janë shlyer, lëshimi i provizionimit kreditohet në pasyrën e të ardhurave.

Për asetet financiare të mbajtura për maturim-shuma bartëse e asetëve zvogëlohet në shumën e përafërt të rikuperueshme qoftë në mënyrë direkte apo përmes përdorimit të llogarisë së lejimit dhe shumës së humbjes përfshihet në pasyrën e të ardhurave.

**h) Valutat e huaja**

Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen në kurisin e këmbimit të asaj dite. Ndyshimet për shkak të kursit valutor nga transaksionet në valuta të huaja përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin valutor të asaj dite. Asetet monetare dhe detyrimet të denominuara në valuta tjera pos Euro-s këmbehen në Euro me normën mesatare të këmbimit në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo-monetar të bartura me vlerë të tregut që janë denominuar në valuta të huaja janë rikëmbyer me normat që kanë mbizotëruar në datën kur vlera e tregut është përcaktuar. Zërat jo-monetar që maten në konditat e kostove të mëparshme në valuta të huaja nuk rikëmbehen. Fitimet dhe humbjet nga vlerat e huaja që rrjedhin nga këmbimi asetëve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si fitime të këmbimit të valutës së huaj pa humbjet.

**i) Patundshmëritë, impiantet dhe paisjet**

Pratunshmëritë, impiantet dhe paisjet janë vlerësuar në bazë të kosotos duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe provizionimin nga heqjet prej përdorimit, aty ku kërkohet. Kosto përfshinë shpenzimet që janë direkt të inkuadruara në blerjen e asetëve. Aty ku njësi të pasurisë ose paisjeve kanë vlerë të ndryshme të jetëgjatësisë, ato paraqiten ndamas.

Kosot e zëvendësimit të një pjese të pasurisë ose paisjeve njihet në vlerën bartëse nëse priten që të mira të ardhshme do të ketë. Shpenzimet ditore për mirëmbajtjen e pasurisë dhe paisjeve njihen në fitim ose humbje. Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave në me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të pasurisë dhe paisjeve. Asetet me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtë bazuar në marrëveshjen për qira dhe jetëgjatësisë së tyre. Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën është si më poshtë:

<b>Kategoritë e asetëve</b>	<b>Normat e zhvlerësimit të përdorura</b>
Investimet ne objektet me qira	5 vite
Paisjet kompjuterike	5 vite
Veturat	5 vite
Paisjet e tjera	5 vite

**j) Pasuria e paprekshme**

Softveri i blerë nga Banka është vlerësuar në kosto, zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e zhvlerësimit. Shpenzimet e mëpasme të softverit kapitalizohen vetëm atëherë kur t'i rritet vlera ekonomike e ardhshme për asetet specifike. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në bazë të ndodhjes.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare duke u bazuar në vlerësimin e jetëgjatësisë së softverit, nga data që është futur në përdorim. Jetëgjatësia e softverit konsiderohet të jetë dhjetë vite.

## 3.POLITIKAT BAZË KONTABILE (VAZHDIM)

